



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstva za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education, Science and Technology

Raport përmbledhës mbi gjetjet nga monitorimi dhe mentorimi i DKA-ve dhe shkollave, lidhur me funksionimin e EPRBMSH



Prishtinë, nëntor 2017

Përmbajtja

<u>I. Përmbledhje ekzekutive</u>	3.
<u>II. Hyrje</u>	7.
<u>III. Objektivat</u>	12.
<u>IV. Metodologjia</u>	14.
<u>Kapitulli I</u>	17.
<u>1. Konteksti ligjor</u>	17.
<u>1.1 E drejta për arsim</u>	18.
<u>1.3. Aspektet procedurale</u>	21.
<u>1.4. Udhëzimi Administrativ 19/2012 për themelimin e EPRBMSH</u>	22.
<u>1.5. Sistemi i Paralajmërimit të hershëm të braktisjes</u>	24.
<u>Kapitulli II</u>	26.
<u>3. Rezultatet nga monitorimi dhe mentorimi në DKA dhe shkolla</u>	26.
<u>3.1. Gjetjet në DKA</u>	27.
<u>3.2. Gjetjet në shkolla</u>	32.
<u>Kapitulli III</u>	38.
<u>3.1. Përfundim</u>	38.
<u>3.2. Rekomandime</u>	40.
<u>Shtojca</u>	44.

Përmbledhje ekzekutive

Republika e Kosovës, respektivisht Minisria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka bërë përparime të konsiderueshme drejt promovimit të politikave gjithëpërfshirëse në arsim, në drejtim të mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve dhe realizimit të mundësive të barabarta në arsim për të gjithë. Ndonëse kuadri ligjor dhe politikat arsimore garantojnë gjithëpërfshirje dhe arsimim cilësor për të gjithë, pa dallim gjinie, etnie, aftësie a gjendje tjetër, shoqëria kosovare përballet ende me barriera të ndryshme që krijojnë vështirësi në realizimin e të drejtës së arsimit për të gjithë.

Në funksion të zbatimit të politikave për arritjen e gjithëpërfshirjes, po e vëmë theksin në përpjekjet e vazhdueshme të MASHT-it me partnerë e vet në adresimin e problemit të braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollimit, ku e kemi një avancim të sistemit për sa i përket mekanizmave për identifikim, trajtim dhe referim të rasteve në rrezik të braktisjes.

Veprimet me qasje për avancimin e sistemit, janë shoqëruar me ngritjen e kapaciteteve të komunave/ DKA-ve dhe shkollave në adresimin e problemit të braktisjes duke e marrë në konsideratë edhe ndërgjegjësimin e personelit shkollor mbi faktorët e rrezikut që mund t'i shpiejnë fëmijët drejt braktisjes së shkollimit. I bie që sistemi i ndërtuar mbi normat legislative synon vëmendjen e plotë të të gjitha subjekteve brenda shkollave, DKA-ve dhe shërbimeve tjera për t'i mbajtur nxënësit në shkolla dhe brenda tyre t'u ofrohen shërbime cilësore edukativo-arsimore, duke siguruar mbrojtjen e tyre, bazuar në të drejtat e fëmijëve/ njeriut.

Pas risive në legjislacion u krijuan mekanizmat përkatës, Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe regjistrimit në arsimin e obliguar si dhe u krijua baza e instrumenteve me të cilat mund të maten rreziqet dhe të identifikohen rastet në predispozitë të braktisjes si dhe ata që e braktisin shkollimin. Mbi këtë bazë, shkollave u është krijuar lehtësia e identifikimit, trajtimit dhe referimit të rasteve (në kohë reale) sipas

legislacionit në fuqi, mirëpo me gjithë trajnimet, sesionet informative në disa shkolla dhe në të gjitha DKA-të, ka nevojë të shtrirjes së informacionit në çdo shkollë ashtu që mekanizmat të funksionojnë në mënyrë uniforme, sipas politikës multidisiplinare.

Ky raport përmbledh anën legislative dhe operative të punës së MASHT me partnerët e vet si dhe gjetjet nga procesi i monitorimit dhe mentorimit në 21 komuna të Republikës së Kosovës, mbi zbatimin e politikave kundër braktisjes së shkollimit në praktikën e përditshme të shkollave, dhe DKA-ve. Krahas gjetjeve dhe opinioneve tona, shihni edhe rekomandimet relevante për institucionet përgjegjëse në të gjitha nivelet.

Hyrje

Për të siguruar qasje të barabartë në arsim, MASHT ka treguar përkushtimin e veçantë në trajtim të problemit të braktisjes. Kështu, në vazhdimësinë e aktiviteteve për zbatimin e legjislacionit vendor (Ligjit të arsimit parauniversitar dhe akteve nënligjore), ***Konventës për të drejtat e fëmijëve, Planit Strategjik të Arsimit dhe Planit kombëtar të Veprimit kundër Braktisjes së shkollimit***, MASHT në vitet e fundit i ka realizuar një varg aktivitete:

- MASHT çdo vit i jep tekstet falas për të gjithë nxënësit e arsimit të obliguar (1-9), gjë që ndikon në parandalim të braktisjes;
- MASHT ka hartuar dhe shpërndarë në drejtori komunale të arsimit ***U.A. Krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e***

obliguar dhe tashmë janë në dispozicion ekipet në nivel shkollash dhe komunash

- MAShT çdo vit liron nga pagesa e arsimit joformal të gjitha rastet sociale.
- Komunat e Kosovës sigurojnë transportin e nxënësve në largësi prej 4 km deri në shkollë dhe për fëmijët me aftësi të kufizuara sigurohet transporti nga MAShT, me çka parandalohet braktisja e shkollimit.
- Komunat ndajnë bursa për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë, të kategorive të familjeve që marrin ndihmë sociale, të atyre pa prindër, ndërkaq MAShT me partnerë çdo vjet ndanë bursa për nxënësit e komuniteteve RAE, etj.
- Grupi për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, në nivel të MAShT është funksional dhe po i koordinon veprimet me të gjitha subjektet relevante.

- Në koordinim të MAShT, Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI Kosovo) dhe me financim nga UNICEF, po zbatohet Programi: "Avancimi i qasjes dhe vazhdimit të vijimit të arsimit për fëmijët e cenuar dhe të margjinalizuar".
- Brenda këtij bashkëpunimi MAShT hartoi udhëzuesit për punën e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, për nivel shkolle dhe komune, ndërkohë që në bashkëpunim me OSBE-në u hartuan termat e referencës për punën e këtyre ekipeve, bazuar në U.A. 19/2012.
- Fillimisht në këtë program janë përfshirë 9 komuna: Peja, Ferizaji, Fushë Kosova, Obliliqi, Rahoveci, Klina, Istogu, Gjakova, Podujeva, të cilat u mbështetën për zbatimin e *U.A 19/2012 për Krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar* si dhe për hartimin e planeve të veprimit në nivel komunal

për adresimin e problemit të fëmijëve jashtë shkollës.

- Ky projekt u shtri edhe në 21 komunat tjera: Deçan ,Junik, Dragash, Gjilan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë, Vushtri , Skenderaj, Prishtinë, Prizren Suharekë, Shtërpçë, Shtime, Drenas, Han i Elezit, Kaçanik, Kamenicë, Lipjan, Novo Bërdë dhe Viti , të cilat u mbështetën me trajnime dhe sesione informative.
- U hartua Plani i ri i veprimt kundër braktisjes
- U hartua korniza monitorues e Planit të veprimt, me indikatorët e tri niveleve, gjë e cila na ndihmon matjen e rezultateve karshi objektivave dhe aktiviteteve, si dhe të ndikimit të përgjithshëm të këtij plani në sistemin arsimor.
- U zhvillua dhe është funksional Moduli për Sistemin e Paralajmërim të Hershëm (SPH) të braktisjes në SMIA, modul ky që rrit premisat për punë më efikase në parandalim dhe reagim ndaj braktises së shkollës.

- Shkollat kanë filluar të funksionojnë sipas këtij sistemi dhe aktualisht gjatë vitit shkollor 2016-17, i kanë regjistruar 49 raste në SPH.
- Po bëhet monitorimi dhe mbështetja e vazhdueshme në shkolla dhe komuna.

Pra, pas një kronologjie pune ndër vite, MASHT në koordinim me partnerë si: UNICEF, CRS, SHPAK, ECMI, GIZ, OSBE, etj. krijoi bazë të qëndrueshme për punë kundër braktisjes së shkollimit. Bazuar në infrastrukturës ligjore, tani më i kemi edhe mekanizmat në nivel shkollash, komunash dhe në MASHT.

Gjithashtu i kemi doracakët dhe instrumentet për identifikim, raportim dhe referim të rasteve si dhe mundësinë e raportimit në Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm të braktisjes brenda Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim, përdorimi i rregullt i të cilit na ndihmon në evidentimin dhe trajtimin e duhur e në kohë reale të rasteve në rrezik të braktisjes.

Tani mbi bazën e kësaj pune lipset që mësimdhënësit, udhëheqësit e shkollave, zyrtarët arsimorë, prindërit e të tjerë, të ushtrojnë rolin e tyre dhe të veprojnë me përgjegjësi për të realizuar të drejtën e arsimit për të gjithë!

Objektivat

Monitorimi dhe mentorimi i shkollave dhe DKA-ve, respektivisht i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollave (EPRBMSH) kishte në fokus këto objektiva:

- 1. Identifikimin e gjendjes për sa i përket themelimit dhe funksionimit të EPRBMSH**
- 2. Si dhe mbështetjen e shkollave dhe DKA-ve në funksionalizimin e këtyre mekanizmave**

Kjo qasje ka për qëllim adresimin e barrierave që e cënojnë gjithëpërfshirjen në arsim, duke ngritur kapacitetet e shkollave në identifikimin, raportimin dhe trajtimin e rasteve në rrezik të braktisjes.

Vlerësimi i mekanizmave dhe i përkushtimit institucional për garantimin e vijueshmërisë së rregullt të shkollimit në arsimin e obliguar dhe si dhe për matjen dhe adresimin e faktorëve të rrezikut që e cënojnë shkollimin e fëmijëve tanë, ishte prioriteti i vendosur nga Grupi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës në nivel të MASHT, i cili do ta përcjell këtë çështje në vazhdimësi.

Metodologjia

Procesi i monitorimit të shkollave dhe DKA-ve u shoqërua me mentorim me qëllim të mbështetjes së mekanizmave për funksionimin konform politikave të përcaktuara, prandaj shfrytëzuam një metodologji mikse, ashtu që krahas pjesës teorike mbi qasjen institucionale ndaj kësaj problematike, përdorëm edhe metodat sasiore e cilësore për grumbullimin e të dhënave nga takimet me ekipet e shkollave dhe DKA-ve.

Gjatë këtij procesi përdorëm teknikat relevante si: Intervistat gjysmë të strukturuar, pyetësorët dhe diskutimet me përfaqësuesit e shkollave/ ekupeve).

Në përgjithësi këto teknika janë përdorun në 21 komuna: Deçan ,Junik, Dragash, Gjilan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë, Vushtrri , Skenderaj, Prishtinë, Prizren Suharekë, Shtërpçë, Shtime, Drenas, Han i Elezit, Kaçanik, Kamenicë, Lipjan, Novo Bërdë, dhe Viti, në gjithsesj 25 shkolla.

Shkollat e monitoruara/ mbështetura ishin:

1. "Asim Vokshi", Prishtinë
2. "Fazli Grajqevci", Mitrovicë
3. "Abdullah Shabani", Mitrovicë
4. "Shaban Jashari", Skënderaj
5. "Fetah Sylejmani", Dragash
6. "Samidin Emini", Dragash
7. "Abdyl Frashëri", Prizren
8. "Mati Logorec"i, Prizren
9. "Anadollu", Mamushë
10. "Shkëndija", Suharekë
11. "Emin Duraku", Shtime

12. "Dëshmorët e kombit", Ngucat-
Malishevë
13. "Emin Duraku", Kaçanik
14. "Ilaz Thaqi", Hani i Elezit
15. "Dëshmorët e 5 prillit", Viti
16. "Ismail Luma", Lipjan
17. "Ibrahim Krasniqi", Lipjan
18. "Thimi Mitko", Gjilan
19. "Gjergj Kastriot Skënderbeu", Pantinë-
Vushtrri
20. "SHMU 1", Vushtrri
21. "Hanumshahe dhe Tefik Zymberi", Novo
Bërdë
22. "Osman Mani", Shtërpçë
23. "Xheladin Gashi-Plaku", Drenas
24. "Edmond Hoxha", Junik
25. "Idriz Seferi", Kamenicë

Pas grumbullimit të dhënave nga terreni, është bërë analiza e tyre dhe i tërë procesi është përmbyllur me rekomandime relevante konform nevojave dhe rrethanave kontekstuale të komunave dhe shkollave tona,

me synimin për ta ndihmuar zbatimin dhe zhvillimin e politikave adekuate të gjithëpërfshirjes në arsim cilësor.

Monitorimin dhe mentorimin e realizuan këta anëtarë të EPRBM nga MASHT: Sahit Berisha, Merita Jonuzi, Shqipe Bruqi, Shyhrete Reqica, Aferdita Jaha, Arian Mustafa, Fetah Kasumi dhe Imrane Ramadani, ndërkaq nga ECMI: Arben Osmani dhe Zihnie Gurmani.

KAPITULLI I

1. 1. Konteksti ligjor/ Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Janë një varg konventash dhe standardesh ndërkombëtare, të cilat kërkojnë qasje dhe mundësi të barabartë në arsim cilësor, prandaj shtetet kanë detyrim të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar të drejtën e arsimit për të gjithë qytetarët e vet, pa dallim gjinie, etni, aftësia e gjendje tjetër.

Meqë po flasim për shkollat dhe nxënësit/ fëmijët e arsimit parauniversitar, po i referohemi ekskluzivisht **Konventës për të Drejtat e Fëmijës**, si traktati që i mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse të drejtat e fëmijës në çdo cep të botës. Duke u thirrur në këtë konventë, shtetet orientojnë politikat nacionale, prandaj edhe konsiderohet si bazamenti i të drejtave universale për çdo fëmijë/ individ.

Parimet bazë të kësaj konvente janë: **Pjesëmarrja** (pjesë intergale e secilit nen ngase Konventa garaton

pjesëmarrje dhe mundësi të barabarta në realizimin e të gjitha të drejtave), **Mosdiskriminimi (neni 2)**, **Interesi më i lartë i fëmijës (neni 3)** dhe **Zhvillimi i potencialit të plotë (neni 6)**. Kështu, në kontekst të shërbimeve arsimore, legjislacioni ynë udhëhiqet nga këto parime për të garantuar pjesëmarrje të barabartë (pa asnjë diskriminim) në arsim cilësor, për të vepruar sipas interesit më të lartë të fëmijëve si dhe për të siguruar zhvillimin e potencialit të plotë të tyre, përfshirë zhvillimin fizik, intelektual, emocional, njohës social e kulturor.

1.2. E drejta për arsim në kontekstin e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Nenin 47) dhe legjislacioni i arsimit garantojnë të drejtën e arsimimit për të gjithë pa dallim gjinie, etnie, aftësie a gjendje tjetër, duke pasur për bazë të drejtat e njeriut/ fëmijës.

Ligjet aktuale: Ligji për Edukimin Parashkollor, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Arsim dhe

Aftësim Profesional, Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur, Ligji për Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, etj, bashkë me aktet nënligjore përcjellëse adresojnë mundësitë e barabarta dhe qasjen e gjithëpërfshirëse në arsim cilësor.

Barrierat e natyrave të ndryshme brenda sistemit arsimor, sidomos ato të qasjes në arsim, ndërlidhur me faktorët e shumtë individualë, familjarë, shoqërorë me kontekste të ndryshme sociale, ekonomike, shëndetësore e kulturore, kërkojnë qasje multidisiplinare, prandaj i kemi ligjet tjera relevante si: Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, Ligji i Policisë, shëndetësisë etj, që bashkë me rregulloret dhe mekanizmat tjerë institucionalë, na e kërkojnë bashkëveprimin e plotë për të funksionuar si hallka të shtetit në adresimin e problemeve me të cilat ballafaqohemi.

Legjislacioni i arsimit, obligon institucionet përgjegjëse si: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Komunitet, institucionet arsimore dhe komunitetin, që të

marrin të gjitha hapat e arsyeshëm që institucionet arsimore të jenë cilësore, gjithëpërfshirëse, humane dhe të sigurta, siç e kërkojnë politikat arsimore, përfshirë standardet për shkollat mike, kurrikulat dhe secila hallkë e sistemit arsimor.

Pastaj kemi dokumentet strategjike relevante që për prioritet kanë pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen në arsim, prandaj po i listoj disa nga më kryesoret:

- Plani Strategjik i Sektorit të Arsimit në Kosovë (PSAK),
- Plani Nacional kundër braktisjes,
- Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë,
- Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Janë edhe dokumentet tjera strategjike ndërsektoriale dhe procedurat standarde që adresojnë aspektet e qasjes në arsim të viktimave të trafikimit, dhunës, krimit dhe rrethanave tjera çfarëdo qofshin ato.

1.3. Aspekte procedurale/ Aktet nënligjore

Ekzistojnë një varg aktesh nënligjore që ndihmojnë zhvillimin e procedurave për sigurimin e qasjes e barabartë në arsim, si në vijim:

- Udhëzimi administrativ nr. 13/2005 për masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në arsimin obligativ,
- Udhëzimi administrativ 19/2012 për krijimin dhe fuqizimin e EPRBM në arsimin e obliguar,
- UA- 03/2012 Njohja dhe barasvlera e dokumenteve të arsimit parauniversitar,
- UA-19/2015 Sistemimi i nxënësve të riatdhesuar që kanë migruar në vitin 2014-2015,
- UA-01/2016” Organizimi i kurseve të gjuhës dhe mësimi plotësues”
- Udhëzimet relevante për arsimin e të rriturve,

Të gjitha këto, bashkë me mekanizmat për sigurimin e cilësisë, licencimin e mësimeve dhe ato për matjen e performancës në arsim, mund të krijojnë rrethana optimale që shkollat tona dhe institucionet tjera udhëheqëse të ushtrojnë rolin e duhur në sigurimin e mbarëvajtjes së sistemit arsimor dhe tejkalimin e problemeve që e çenojnë atë.

1.4. U.A 19/2012 për Krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit në arsimin e obliguar

Po ndalemi te fokusi i veprimeve tona për mekanizmat kundër braktisjes, të themeluara sipas U.A 19/2012 për Krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit në arsimin e obliguar

Brenda objektivës *Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja*, MASHT në vazhdimësi e ka adresuar problemin e braktisjes së shkollimit. Pas një pune të gjatë me projekte të ndryshme ndër vite, vite, u nxor U.A 19/2012 për Krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit në arsimin e obliguar, sipas të cilit janë themeluar ekipet në nivel shkollash dhe komunash.

Ekipet e shkollave, sipas detyrave dhe përgjegjësiive merren me identifikim, trajtim dhe referim të rasteve në rrezik të braktisjes si dhe ndërmarrin veprime në kthimin e atyre rasteve të nxënësve që për çfarëdo arsye e kanë braktisur shkollimin. Në rastet kur mekanizmat shkollorë nuk arrijnë sukses dhe veprimet e mëtejshme dalin jashtë kompetencave të tyre, duhet të kërkojnë kontributin e instancës tjerë, EPRBMSH në nivel komune, e cila është me përbërje multidisiplinare dhe e mandatuar t`u gjejë zgjidhje rasteve të referuara nga shkollat.

Në gjithë këtë proces, shkollat duhet të përdorin instrumentet për identifikim, raportim dhe referim të

rasteve në rrezik të braktisjes, siç i kemi hartuar (MASHT, UNICEF, ECMI) dhe përmbledhur në doracakët për punën e ekipeve në nivel shkollash dhe komunash.



1.5. Sistemi i paralajmërimit të hershëm të braktisjes

Bazuar në këto instrumente matëse të rrezikut dhe për zhvillimin e procedurave, MASHT e ka zhvilluar dhe është aktiv: Moduli për paralajmërim të hershëm të braktisjes në Sistem të menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA), modul ky që rrit premisat për punë më

efikase në parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollës.

Gjatë vitit të parë të funksionalizimit të tij (viti shkollor 2016-2017), në këtë modul janë regjistruar 49 raste të rrezikut të braktisjes, të cilat po trajtohen nga shkollat dhe mekanizmat përkatës.

Shkollat që kanë raportuar në SPH deri tani janë :

“Asim Vokshi” dhe “7 shtatori “ në Prishtinë,
“Mustafa Bakija” dhe “Zef L. Marku “ në Gjakovë
,”Tefik Çanga” në Ferizaj, “Gj.K.Skenderbeu’ në
Vushtri, “Idriz Seferi “ në Kamenicë, “Dëshmorët e
Kombit” në Ngucat, Malishevë, si dhe “Mehdi e
Sylejman Bytyqi” në Drenas.

Këto shkolla konsiderohen të vëmendshme dhe të përgjegjshme ndaj detyrimeve që i kanë karshi rasteve në rrezik të braktises dhe atyre që e kanë braktisur shkollimin, prandaj meritojnë mirënjohjen dhe falënderimin nga institucionet dhe komuniteti në zonën e tyre të mbulimit e më gjerë.

KAPITULLI II

2.1. Rezultatet nga monitorimi dhe mentorimi i DKA-ve dhe shkollave

Siç u tha më lart, në proces të monitorimit dhe mentorimit janë përfshirë 21 komuna dhe 25 shkolla. Në secilën komunë kemi vizituar kryesisht një, por diku dy shkolla (Mitrovicë, Vushtrri, Prizren) për të pranuar indikacionet e nevojshme për vlerësimin e situatës për sa i përket funksionimit dhe fuqizimit të mekanizmave që janë themeluar rishtas (Ndonëse U.A është prej vitit 2012, ekipet filluan të themeloheshin vetëm pas mobilizimit të MASHT dhe partnerëve mbështetës në ngritjen e kapaciteteve të DKA-ve dhe shkollave). Në këtë proces, por vetëm për efekt mentorimi i kemi përfshi edhe tri shkolla tjera në Mitrovicë: ”*Bedri Gjinaj*”, ”*Shemsi Ahmeti*” dhe ”*Nonda Bulka*” (me kërkesë të ekipës komunale atje).


Tani, anëtarët e ekipit në nivel të MASHT, të shoqëruar nga përfaqësuesit nga ECMI, kanë realizuar këtë proces

monitorimi dhe mentorimi duke shfrytëzuar pyetësorët e hartuar paraprakisht nga MASHT, dedikuar shkollave dhe komunave. Kur themi se edhe i kemi mentoruar DKA dhe shkollat, e kemi parasysh që u kemi dhënë instruksionet e detajuara për mënyrën funksionimit të ekipeve dhe adresimit të problemit të braktisjes.

2.2. Gjetjet në DKA/ Rezultatet


Duke iu referuar pyetjeve dhe përgjigjeve të pranuar, shoqëruar me faktet e ofruara në terren, shohim se 19 komuna e zbatojnë U.A për themelimin dhe funksionimin e ekipeve dhe rrjedhimisht i kanë themeluar ekipet dhe i për dorin doracakët. Ndërkaq 2 DKA (Dragashi, Prishtina) ende nuk i kanë themeluar ekipet, prandaj qasja e tyre ndaj problemit të braktisjes së shkollimit është vetanake e jo uniforme sipas politikave të përcaktuara dhe sistemit të ndërtuar.

Graf. Nr.1. Përqindja e DKA-ve që e zbatojnë U.A 19/2012



Nga ato DKA që i kanë themeluar ekipet, 15 prej tyre kanë takime të rregullta me procesverbale e 4 nuk kanë mbajtur takime.

Gr.nr 2. DKA që i kanë funksionale EPRBMSH dhe që kanë mbajtur takime të rregullta



Me a pa takime të mbajtura janë identifikuar 31 raste të referuara në DKA, e të cilat janë trajtuar, kryesisht në koordinim me QPS-të.

Sa i përket organizimit të transportit, të gjitha DKA-të ndajnë fonde për transportin e nxënësve, ndërkaq 5 komuna (Skenderaj, Prizren, Hani i Elezit, Suhareka, Viti) ndajnë edhe fonde për bursa shkollore, përveç atyre studentore, me buxhet të komunës dhe me mbështetje nga donatorët (KARITAS-i mbështeste Hanin e Elezit). Vushtrria nuk kishte fonde për bursë, por shpërblime për nxënësit e dalluar.

DKA-të gjithashtu kanë nominuar koordinatore për gjithëpërfshirje në arsim, për çka edhe shihet një përkujdesje e shtuar ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara, por edhe rritje të mundësive për përfshirje më të madhe në parafillor. Rritja apo rënia e numrit të fëmijëve në parafillor, lidhet ngushtë me natalitetin, të dhënat demografike, por edhe me migrimin. Sipas të dhënave të gjetura në komuna, 18 DKA kishin rritje, 2 rënie (Dragash dhe Viti), ndërkaq Mamusha kishte numër të njëjtë të fëmijëve në arsimin parafillor.

DKA e Suharekës, potencoi problemin e procedurës së fletëkalimit, me rastin e transferimit të një nxënësi, nga një shkollë në tjetrën. Zyrtari kompetent i kësaj komune pretendon se disa prindër po e shfrytëzojnë këtë procedurë për t'i ndalur fëmijët nga shkolla dhe nuk kthejnë informatën konfirmuese në shkollën paraprake. Shih për këtë, ai sugjeroi që procedurën e transferit ta zhvillojë shkolla me shkollë, por jo nëpërmjet të prindërve.

Duke pasur parasysh se faktori i sigurisë është nga rreziqet që cënon vjueshmërinë e rregullt të fëmijëve në shkollë, morëm opinionin e zyrtarëve të DKA-ve mbi këtë çështje, e cila rezultoi me konsideratën që siguria është në nivel meqë shkollat kanë kamera dhe shumica e kanë të organizuar sigurimin e shkollës. Ata vunë theksin te rreziqet në komunikacion dhe nga qentë endacakë.

Sa i përket Sistemit të paralajmërimit të hershëm, stafi i DKA-ve kishin informacion për prezencën e këtij moduli në SMIA, por se nuk e përdornin sa dhe siç duhet. Kishte ndonjë komunë që e konsideronte problem mungesën e një personi adekuat për përdorimin e SPH-së.

Nga këto të dhëna në vija të trasha, shohim se DKA si hallkë shumë e rëndësishme për mbarëvajtjen e punës së shkollave, ka ende për të bërë në drejtim të funksionimit konform platformës së ndërtuar për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë. Themelimi dhe funksionalizimi i EPRBM do të ndihmonte trajtimin me qasje multidisiplinare të rasteve të referuara nga shkollat, ngase rastet që referohen në DKA kanë dimension përtej mandateve ligjore të institucioneve arsimore dhe gjithsesi kërkohet kontributi i institucioneve tjera , anëtare të EPRBM-së komunale.

Në anën tjetër, funksionimi i efikas i EPRB- ve komunale dhe vëmendja e duhur në funksionimin e shkollave sipas U.A përkatës, do të siguronte informacionin e duhur mbi gjendjen e shkollave dhe DKA-ve në lidhje me problematikën e braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë. Sistemi i paralajmërimit të hershëm të braktisjes do të siguronte përkushtimin e shkollave dhe DKA-ve në parandalim dhe trajnim efikas të rasteve në rrezik të braktisjes dhe atyre braktisës, duke lënë dëshmi/ gjurmë mbi veprimet legjitime të shkollave dhe DKA-ve, sipas mandateve që i kanë me

legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, puna e mëtejme, bazuar në dëshmi dhe statistika sasiore dhe cilësore do të ndihmonte shkollat, DKA-të dhe MASHT-in në orientimin e politikave të sakta, në përputhjen me situatën/ gjendjen reale.


2.3. Gjetjet në shkolla/ Rezultatet

Për dallim nga DKA-të, shkollat qëndronin më mirë për sa i përket themelimit dhe funksionimit të ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollave.

Nga 25 shkollat e monitoruara, 24 e zbatonin U.A . 19/2012, i kishin themeluar ekipet, por jo të gjitha praktikonin doracakët dhe instrumentet për identifikim, trajtim dhe referim të rasteve në rrezik të braktisjes. Si rrjedhojë e kësaj qasjeje, rastet i trajtonin dhe i evidentoni në mënyrën e vet por jo sipas instrumenteve mbi bazën e të cilave krijohen dosjet dhe bartet informacioni në SPH/ SMIA (kemi disa përjashtime, p.sh. shkolla "Asim Vokshi" në Prishtinë, pjesërisht edhe shkollat e Mitrovicës, "Fazli Graiqevci",

”Abdullah Shabani” që funksionojnë sipas platformës së ndërtuar),

Gr.nr.3. Përqindja e shkollave që e zbatojnë U.A. 19/2012




Këto shkolla sivjet i kishin gjithsej 36 raste¹ në rrezik të braktisjes/ braktisës që po i trajtonin, e disa prej tyre i kishin përfunduar me sukses. Nëse krahasojmë me të dhënat e evidentuara në SMIA, vitin e kaluar i kishim 49 raste të raportuara e sivjet i kemi 2 raste. I bie që shkollat nuk po i regjistrojnë rastet siç kërkon sistemi i ndërtuar për paralajmërimin e hershëm të braktisjes. Në monitorim i kishim 25 shkolla dhe na dolën 36 raste, prandaj e kemi parasysh që nëse merren në trajtim të gjitha shkollat e R.

¹ Në DKA ishin referuar 31 raste

së Kosovës, mund ta kemi një shifër të lartë të rasteve në rrezik, ndaj të cilave kemi detyrim ligjor për t'i trajtuar, duke siguruar që fëmijët t'i mbajmë në shkolla dhe t'u ofrojmë shërbime cilësore në koordinim me shërbimet tjera të nevojshme.

Rastet kryesisht vinin nga probleme të shumta sociale e familjare (29 raste), raste të problemeve me vijueshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuar (3), por edhe të trafikimit me njerëz (4 raste), të cilat po trajtohen tutje nga organet kompetente.

Gr.nr.4. Faktorët e rrezikut të braktisjes



Edhe shkollat, njësoj si DKA potencuan se nuk kishin probleme me sigurinë ngase shumica kishin kamera dhe sigurim të shkollës, por edhe bashkëpunim të mirë me komunitetin dhe policinë e komunitetit. Kjo e fundit kishte rol të madh në parandalim të dhunës gjatë vajtje ardhjes, shkollë -shtëpi dhe përreth hapësirave shkollore, ndërkaq shkollat me mekanizmat e vet po arrinin të menaxhonin situatën brenda hapësirave shkollore (flitej për raste të izoluara dhe të menaxhuara nga vetë shkollat). Ndonëse nuk u deklarua dhuna në shkolla, diskutimet më të thella për rastet në rrezik të braktisjes, jepnin mjaft indikacione për elementet e dhunës në familje, delikuencës dhe rrethana tjera sociale që ndikojnë në përshkallëzim të vështirësive për arsimimin e nxënësve në fjalë (stafi i të gjitha shkollave, pretendonin se e zbatojnë edhe Protokollin për Parandalim dhe Referim të Dhunës në IAP).


Disa shkolla, shprehën shqetësimin për rreziqet në komunikacion, për arsye të pozitës së shkollave në afërsi të rrugëve automobilistike, mirëpo diku-diku kishte edhe reagim për rrezikun nga qentë endacakë. Të gjitha shkollat u shprehën të kënaqura me mbështetjen e

komunave dhe komunitetit të prindërve për transportin e nxënësve në nevojë. Gjithashtu, dy prej shkollave edhe kishin mbështetje me bursë shkollore për nxënësit e shkëlqyeshëm (raste sociale).

Duke qenë se politikat arsimore kërkojnë gjithëpërfshirjen, shihet se shumica e shkollave janë gjithëpërfshirëse dhe kanë nxënës me aftësi të kufizuar, ndërkaq sipas strukturës së komunitetit në zonën e tyre të mbulimit kanë edhe fëmijë nga komunitetet tjera (romë, ashkalinj, egjiptianë, turq, boshnjakë). Sa i përket përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar, të gjitha u deklaruan të tilla dhe janë të gatshme të pranojnë fëmijë dhe aftësi të kufizuara, ndërkaq 10 prej 25 shkollave edhe i kishin 1- 2 deri në 3 raste të fëmijëve me dëmtime të ndryshme. Gjithsej i raportuan 50 raste të fëmijëve me aftësi të kufizuar që i kishin të integruar në arsim të rregull, ndonëse kishin mjaft vështirësi si pasojë e mungesës së mësuesve mbështetës dhe stafit të trajnuar. Konform politikave arsimore shihet edhe pjesëmarrja e më e mirë e fëmijëve në arsimin pafillor ku në shumicën e shkollave ka rritje për rreth 10 % të numrit të nxënësve në parafillor

(Vushtrria kishte 50% rritje të numrin në parafillor).

Gr.nr.5. Përfshirja në parafillor



Rënie ka në 3 shkolla sipas rrethanave demografike, migrimit dhe rënies së natalitetit. Kishte shkolla (4 ose 16.6 % nga shkollat e monitoruara) që viteteve të fundit e kanë njësoj numrin e fëmijëve në arsim parafillor, meqë trendi i natalitetit ishte i njëjtë.

Kapitulli III

3.1. Përfundimi

Nga e gjitha që u tha deri tani, konkludojmë se politikat e parandalimit, identifikimit, trajtimit dhe referimit të rasteve në rrezik të braktisjes dhe ato që e kanë braktisur shkollimin janë mjaft të konsoliduara dhe përmbajtësore. MASHT me partnerët e vet dhe së fundmi me UNICEF-ECMI kanë krijuar një partneritet të mirë në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe cilësor për trajtimin e kësaj problematike. Mbështetja e deritanishme e shkollave dhe DKA-ve ka rezultuar me situatën që e reflekton raporti. Tashmë DKA-të dhe shkollat e dinë se duhet t'i kenë funksionale këto EPRBMSH, meqë gjatë kësaj periudhe u monitoruar dhe u mbështetën DKA-të dhe disa shkolla.

Që ky sistem të jetësohet siç është pretenduar me U.A dhe instrumente përcjellëse lipset ende të punohet me bazë në shkollë ngase aty është burimi i inicimit të veprimeve, por edhe i evidentimit të problemeve në terren. Natyrisht që DKA –të kanë nevojë të jenë më të fokusuara në nxitjen e bashkëpunimit dhe koordinimit

ndërsektorial, ngase karshi rasteve në nevojë, meqë lipsen veprimet dhe shërbimet komunale, të cilat janë të mandatuara me legjislacionin në fuqi.

Përgjithsisht, në të gjitha nivelet duhet të ketë sensibilizim të mirëfilltë për rolet, detyrat dhe përgjegjësitë që i kemi për të siguruar gjithëpërfshirjen në arsim cilësor.

3.2. Rekomandimet

Bazuar në situatën dhe nevojat e evidentuara në shkolla dhe DKA, duke pretenduar fuqizimin e mekanizmave për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, siç e kemi cakun e përcaktuar në Plan Strategjik të Arsimit në Kosovë, po i listojmë rekomandimet si në vijim.

Rekomandimet për shkollë:

- Drejtorët e shkollave të kujdesen për ta mbajtur aktiv dhe funksional Ekipin për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës (EPRBMSH);
- Kujdestarët e klasave të ndihmojnë procesin e identifikimit e hershëm të rasteve në rrezik dhe t'i adresojnë ato te EPRBMSH;
- EPRBMN të dokumentojë veprimet e veta, në formë fizike (procesverbalet e takimeve, dosjet e rasteve) dhe online në SPH, sipas instrumenteve të përcaktuara në doracak;

- EPRBMSH, në koordinim me organet e shkollës, të promovojnë punën e tyre në drejtim të parandalimit dhe reagimit efikas ndaj braktisjes dhe rasteve në rrezik;
- Drejtorët e shkollave të mbajnë aktiv këshillin e prindërve dhe atë të nxënësve për të krijuar partneritetin e duhur në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes;
- Drejtorët e shkollave të koordinohen me aktivet profesionale, por edhe me partnerë të ndryshëm qeveritarë e joqeveritarë për realizimin e aktiviteteve shtesë (debateve, ligjëratave mbi zhvillimet në arsim dhe barrierat në kontekstin e shkollave).

Rekomandimet për DKA

- DKA të sigurojë që EPRBM në nivel komunal të jetë aktiv dhe funksional në shërbim të trajtimit efikas të rasteve që referohen nga shkollat, duke marrë kontributin e duhur të sektorëve të tjerë (të mirëqenies, shëndetësisë, sigurisë etj), sipas specifikave të rasteve të veçanta;

- DKA ta integrojë çështjen e parandalimit dhe reagimin ndaj braktisjes në planin e komunës ose të hartojë plan të veçantë veprimi në nivel komune, me qëllim të adresimit të barrierave të qasjes në arsim;
- DKA të sugurojë buxhet për mbështetjen e aktiviteteve të ekipeve në nivel shkollash;
- DKA të identifikojë dhe koodinohet me partnerë nga shoqëria civile për të mbështetur zbatimin e politikave në adresim të rprobemit të braktisjes së shkollimit;
- DKA të mbajë aktiv Këshillin e Prindërve dhe atë të nxënësve për të krijuar partneritetin e duhur në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes.
- Koordinatorët për gjithëpërfshirje të koordinohen me EPRBMSH në adresimin e problemit të braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë.

Rekomandimet për MASHT

- MASHT të fuqizojë EPRBMSH në nivel nacional, duke e bërë atë multidisiplinar;

- MASHT, respektivisht shërbimet e inspektoratit të shtojnë vëmendjen në mbikëqyrjen e zbatimit të politikave nacionale kundër braktisjes së shkollimit;
- MASHT të mbështesë DKA-të dhe shkollat për fuqizimin e EPRBMSH;
- MASHT të vazhdojë koordinimin me partnerët e vet në trajtimin e problemit të braktisjes dhe fuqizimin e sistemit për paralajmërimin të hershëm të braktisjes.

Shtojca:

- Konventa për të Drejtat e Fëmijës,
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës,
- Ligji për Edukimin Parashkollor,
- Ligji për Arsimin Parauniversitar,
- Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional,
- Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur,
- Ligji për Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë,
- Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës
- Ligji për barazi gjinore
- Ligji kundër Diskriminimit,
- Ligji kundër trafikimit
- Udhëzimi administrativ nr. 13/2005 për masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në arsimin obligativ,

- Udhëzimi administrativ 19/2012 për krijimin dhe fuqizimin e EPRBM në arsimin e obliguar,
- UA- 03/2012 Njohja dhe barasvlera e dokumenteve të arsimit parauniversitar,
- UA-19/2015 Sistemimi i nxënësve të riatdhesuar që kanë migruar në vitin 2014-2015,
- UA-01/2016” Organizimi i kurseve të gjuhës dhe mësimit plotësues”
- Udhëzimet relevante për arsimin e të rriturve,
- Plani Strategjik i Sektorit të Arsimit në Kosovë (PSAK),
- Plani Nacional kundër braktisjes,
- Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë,
- Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar .

**Ky raport u punua nga: Merita Jonuzi,
Koordinatorë për të drejtat e njeriut në MASHT**

